



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS ISTOG

Numri i lëndës: 2021:287539

Datë: 07.02.2022

Numri i dokumentit: 02686621

PPP.nr.54/2021

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG, si përmbarimore me gjyqtarin individual Blerim Istrefi, ne çështjen juridike të kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, kundër debitorit M. T. me nr personal me adresë në Rr. K-Istog, lidhur me pagesën e borxhit në shumë prej 768.24 €, duke vendosur sipas prapësimit te parashtruar nga ana e debitori me dt. 27.07.2021, kundër Urdhrit mbi Lejimin e Përmbarimit, jashtë seancës me datën 07.02.2022, nxjerr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET PJESËRISHT prapësimi i debitorit M. T. nga Istogu, ashtu që:

II.SHFUQIZOHET PJESËRISHT Urdhri mbi Lejimin e Përmbarimit P.nr.172/2019, i dt: 19.02.2019, për periudhën kohore 01.10.2006 e gjerë më 31.12.2017 në shumë prej 712.44 € dhe **OBLIGOHET** debitori M. T. nga Istogu, që kreditorit Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, në emër të borxhit për bartjen e mbeturinave për periudhën kohore 01.01.2018 e gjer me 31.12.2018, t'ia paguaje shume prej 55.80 €, të gjitha këto në afat 7 ditorë, nga dita e pranimit të këtij aktvendimit, nën kërcënim të përmbarimit te detyrueshëm.

A r s y e t i m

Kreditori, Kompania Rajonale e Mbeturinave AMBIENTI SH.A, Njësia Operative Istog, ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit M. T. me nr personal me adresë në Rr. K-Istog, për pagesën e borxhit ne emër të bartjes se mbeturinave për periudhën kohore 01.10.2006 e gjer me 31.12.2018, ne shume totale prej 768.24 €, të gjitha këto në afat 7 ditor në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit, e nëse nuk ka mjete në

llogari të bëhet regjistrimi, sekuestrimi, vlerësimi dhe shitja e sendeve të luajtshme dhe të pa luajtshme e mjetet e mbledhura të derdhen në llogari të kreditorit, të gjitha këto të specifikuara në propozimin për përmbarrim të dt. 19.02.2019.

Organi përmbarrues me Urdhrin mbi lejimin e Përmbarrimit P.nr.172/2019, i dt: 19.02.2019, e ka lejuar përmbarrimin sipas propozimit të kreditorit.

Debitori M. T. me nr personal me adresë në Rr. K-Istog, ka parashtruar prapësim me shkrim, kundër urdhrin mbi lejimin e përmbarrimit, me kërkesë që të shfuqizohet urdhri përmbarrimor pasi që asnjë herë s'jam njoftuar me borxhin dhe un nuk kam qëndruar fare në shtëpi, andaj është borxh paushall dhe pa bazë ligjore, po ashtu jam mbajtës i familjes dhe i pa punë, gjithashtu janë shkelur dispozitat e LMD-së pasi që ka ardhur deri te parashkrimi absolut në kuptim të nenit 360 par. 1 të LMD-së.

Kreditori, është njoftuar me prapësimin e debitorit si dhe me mundësin e parashtrimit të përgjigjes, ku me dt. 28.07.2021 përmes parashtrësës ka ushtruar përgjigje në prapësim, me kërkesë që të refuzohet prapësimi i debitorit si i pa bazuar dhe të vërtetohet urdhri përmbarrimor me arsyetimin se prapësimi i debitorit nuk i përmban asnjë nga shkaqet që parashihen në nenin 71 të LPP-së.

Gjykata Themelore në Pejë – Dega Istog, si përmbarrimore në zbatim të dispozitave të nenit 69 e 71 të LPP vlerësoi prapësimin e debitorit dhe gjeti se të njëjtit është i bazuar pjesërisht. Arsyet e paraqitura në prapësimin e debitorit pjesërisht tregojnë shkaqe sikurse në nenin 69 e 71 të Ligjit të Procedurës Përmbarrimore, sipas të cilave do të pengohej përmbarrimi i lejuar nga përmbarruesi privat.

Gjykata, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, si dhe pas shqyrtimit të pretendimeve në prapësimin e parashtruar nga ana e debitorit kur thirret në atë se nuk jam i njoftuar me borxhin, i cili borxh është paushall dhe pa bazë ligjore si dhe i parashkruar konform nenit 360 të LMD-së, për të njëjtat pretendime gjykata gjeti se janë pjesërisht të bazuara, për faktin se i tërë borxhi me të cilin ngarkohet debitori M. T. me nr personal me adresë në Rr. K-Istog për periudhën kohore 01.10.2006 e gjer me 31.12.2017, është borxh i parashkruar, konform nenit 360 par.1, për faktin se nga transaksioni i kreditorit gjatë kësaj periudhe shihet se debitori nuk ka bërë asnjë pagës të vetme, dhe se me vet faktin se ndërmjet kreditorit dhe debitorit nuk ka ekzistuar paraprakisht një marrëveshje për ri programim eventuale të borxhit, nuk kemi ndërprerje të rrjedhjes së afatit të parashkrimit, konform nenit 368 të LMD-se.

Kurse sa i përket borxhit për periudhën kohore 01.01.2018 e gjer me 31.12.2018, gjykata, gjeti se i njëjti borxh është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim të borxhit të kreditorit, në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 360, par.2 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077), parashihet që afati i parashkrimit për çdo kërkesë të arritur gjatë një viti,

fillon te rrjedhe ne fundin e atij viti, e qe ne rastin konkret për te gjitha kërkesat e arritura ne vitin 2018, afati I parashkrimit ka filluar te rrjedh me 01.01.2019, dhe ne rastin konkret nuk kemi kalim te afatit te parashkrimi, për faktin se kreditori, propozimin për përmbarim e ka parashtruar me datën 19.02.2019, me çka ka shkaktuar ndërprerjen e rrjedhjes se afatit te parashkrimit, konform nenit 369 te Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji nr. 04/L-077).

Duke u bazuar në nenin 17 të LPP-së, gjykata përshtatshmërisht aplikoj dispozitat ligjore Ligjit të Marrëdhënieve te Detyrimeve.

Prandaj nga të lartcekurat, e duke u bazuar ne nenin 3, 29 par.1.2, 1.3, 38, 69, 71, 73 par 3 të LPP-së (Ligjit për Procedure Përmbarimore), ne lidhje me nenin 360 par.1 dhe 2, 368 dhe 369 të LMD-së, gjykata vendosi si ne dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË- DEGA ISTOG
PPP.nr.54/2021 dt: 07.02.2022

G J Y Q T A R I
Blerim Istrefi

UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi, lejohet e drejta në ankesë, në afat prej 7 ditësh, nga pranimi i të njejtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate.